



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-10630-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. 1-

Data / Datum / Date 15.04.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.21.03.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi dhe përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për rritjen e Të Hyrave Vetanake për vitin 2023
4. Raport nga Komisioni për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme
5. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së, për dalje në debat publik të Statutit të QKMF-së "Formën unike të Statutit të QKMF-së
6. Nisma për Bashkëpunimin Ndërkomunal për ndërtimin e rrugës Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë
7. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për plotësim ndryshimin e kapitullit -V- nenit 12 të Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 6 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DEFZH-së, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2023.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në Kuvend. Është një dukuri e mirë që po kërkohet të paraqitet në dokument rritja e të hyrave vetanake dhe raste të tilla kemi çdo vit, ose çdo 6 muaj dhe kjo është mirë.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje të shqyrtohet nëse, veç ka rritje është shumë mirë për pa u ngarkue qytetarët dhe jemi shumë dakord, por në seancë do ti bisedojmë të gjitha çështjet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DEFZH-së, për rritjen e të Hyrave Vetanake për vitin 2023.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin nga Komisioni për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Enver Gashi – Ky raport është raport periodik që bëhet 2 herë në vit dhe vetëm raportohet. Mendoj se është një raport i mirë dhe me kohë, kështu që jemi për që të shkoj në Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe për këtë raport që në njëfarë mënyre nuk votohet, por vetëm raportohet ne jemi shumë dakord që të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal. Krejtë çka kërkojmë është se duke lexuar raportin shehë disa institucione të cilat nuk kanë arritë ta realizojnë planin e tyre dinamik. Në kuadër të këtij raporti kishim pasë dëshirë që Ekzekutivi të vjen me propozime për ata që nuk i kanë realizue kontratat, apo obligimet që i kanë pasë. Përndryshe, jemi shumë dakord për raportin, nuk ka asgjë të keqe.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin nga Komisioni për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DSHMS-së, për daljen në debat publik të Statutit të QKMF-së "Formën unike të Statutit të QKMF-së.

Enver Gashi – Ne jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe pasi të kthehet nga debati publik sigurisht se ne si grup do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës ti adresohet Kuvendit, pastaj Kuvendi të marrë vendim për daljen në debat publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, për daljen në debat publik të Statutit të QKMF-së "Formën unike të Statutit të QKMF-së.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit për Nismën e Bashkëpunimit Ndërkomunal për ndërtimin e rrugës Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.

Enver Gashi – Siç po duket sot ka vetëm tema të mira, tema të lehta për diskutim, edhe kjo nismë për bashkëpunim ndërkomunal është e mirë që kjo rrugë z.Sami, është andej nga ti dhe ne e përkrahim.

Sami Ahmeti – Po e kam parë këtë nismë edhe në Qeveri. Hapja e rrugëve nuk i bën dëm askujt, kështu që jemi shumë dakord që të bisedohet, por të na informohet saktë se cilat janë obligimet e Komunës dhe a ka obligime. E thamë se është me financim të Qeverisë, por cilat janë ato obligime që i kemi ne si Komunë, përndryshe jemi shumë pro dhe jo vetëm këtë rrugë ose këtë bashkëpunim për rrugë mirëpo kudo që ka nevojë që e lidhë Komunën tonë me Komunitat tjera, aq më tepër me atë zonë që i ka dhënë shumë Kosovës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal kërkesën e Kryetarit për Nismën për Bashkëpunimin Ndërkomunal për ndërtimin e rrugës Barilevë-Kozaricë-Dumnicë e Epërme-Kunovik-Vesekoc-Kurillovë-Bajgorë.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DEFZH-së, për plotësim ndryshimin e kapitullit -V- nenit 12 të Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale dhe kërkon sqarim nga shefi i sektorit për ekonomi.

Daut Mjeku – Sqaron se te neni 12 tarifat në biznes është bërë një ndryshim pasi që harmonizimin e kemi marrë prej Kuvendit, prej legjislacionit në fuqi. Komisioni ka punuar dhe kapitulli –V- i taksave për biznes është mirë, por kur kemi ardhë te shtojca e kemi bërë një gabim dhe kërkoj falje sepse e kemi dërguar materialin tjetër. Shtojca nevojitet më shumë për zyrtarët komunal të cilët i kryejnë taksat dhe bëjnë aktvendime. Ne jemi mundue me i harmonizue dhe arsyeja ka qenë se në bazë të veprimtarive ne i kemi marrë edhe veprimtaritë primare dhe veprimtaritë sekondare. Te zejjet, te zejtaritë, te disa veprimtari na ka dalë shumë më keq, dikund ka shkruar tregti e dikund ka shkruar shitje dhe këtë e kemi harmonizuar me Komision. Unë ua kam sjellë edhe tabelën me numër 3 që tash është e mirë dhe vetëm taksat ndryshojnë që mos me pasë bariera, bile te zejtaria e te disa veprimtari më të vogla, që biznesi mos të ndjehet i ngarkuar me taksa dhe i kemi lirue disa prej taksave. Ne e kemi bërë harmonizimin edhe me këto të KEKut dhe të gjitha tjerat në bazë të veprimtarive, prandaj tash është më mirë se sa që ka qenë përpara sepse e kemi parë se nuk kanë shkue ato tarifa qysh ne e kemi menduar. Edhe e kërkojnë bizneset dhe duhet me qenë ajo taksë që mos me ngarkue biznesin më shumë se që duhet me ngarkue sepse ai ka edhe obligime tjera. Ne kemi shkue në bazë të veprimtarisë, e jo në bazë të numrit të punëtorëve, jo në bazë të rrjedhjes së parasë, por vetëm me caktue një veprimtari e cila duhet me u krye dhe është një e hyrë komunale.

Enver Gashi – Ne jemi për shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj kërkesë në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Tashti, këto ndryshimet, gabimet, apo plotësim ndryshimet ndodhin gjithandej nëpër Ligje, Rregullore dhe vendime të ndryshme. Ne jemi që kjo çështje të bisedohet në seancën e Kuvendit Komunal. U folë për taksat dhe mirë që ka zbritje për shkak se duke marrë parasysh se Obiliqi është shumë afër Prishtinës, shumë shpesh bizneset po na ikun e po shkojnë në Komunat tjera, kështu që çdo gjë që ka mundësi për lehtësira ndaj tyre do të ishte e mirëseardhur. Mirëpo, këto çështje do ti bisedojmë në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesja – Ju njoftoj se me z.Mjeku e kemi kontaktuar edhe Ministrinë e tregtisë dhe industrisë, të cilët thanë me ua dërgue këtë kapitull dhe një shkresë, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjegje që ata me pa paraprakisht se a është në rregullë edhe pse është çështje e brendshme e Komunës sepse janë taksat komunale. Ndoshta, deri në mbledhjen e Kuvendit marrim ndonjë përgjegje prej tyre.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DEFZH-së, për plotësim ndryshimin e kapitullit -V- nenit 12 te Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Peticionit (Ankesa) nr.-II-7457/24 e dt.13.03.2024 nga banorët e fshatit Graboc i Epërm për rrugën e cila lidhë fshatin Graboc me Obiliqin.

Enver Gashi – Fatkeqësisht tash është keq të diskutohet për një peticion që qytetarët e asaj ane kanë qenë të detyruar ta bëjnë për pengesat që i ka bërë operatori ekonomik KEK-u. Ai fillimisht është dashtë me mendue ndoshta, edhe ne më heret që kjo rrugë që e kanë propozue ata të rregullohet mirë pastaj, të vazhdohet me mihje sipërfaqësore. Ne jemi për qytetarët sepse ata na kanë sjellë këtu dhe kërkesat e tyre ne duhet shumë seriozisht ti shqyrtojmë. Pra, jemi që ky peticion të kaloj në Kuvend dhe atje anëtarët e Kuvendit do ta japin kontributin e tyre që menjëherë të zgjidhet ky problem.

Sami Ahmeti – Fakti që ka ardhë një menaxhment i ri në KEK, një menaxhment normal e konsideroj unë sepse të tjerëve iu ka interesuar vetëm për Komunat tjera, edhe për çështjet tjera. Unë jam shumë dakord që kjo temë e cila me secilin qytetar të asaj zone kur takohemi është shqetësim dhe është problem edhe pse ne kemi thënë shumë shpeshë se pa ndihmën e Ekzekutivit, këto kërkesa që po vinjë nuk është që mundet Kuvendi Komunal me dalë me një vendim sepse janë institucionet tjera të obligueshme, që vendimet tona me na i bartë përpara. Është mirë me qenë Ekzekutivi këtu, me tregue se kjo temë nuk është e re, është temë me vite të tëra dhe me na tregue se çka kanë bërë, çfarë përpjekje kanë bërë dhe çfarë përgjegje kanë marrë. Mirëpo, unë po e vendosi në dispozicion edhe veten time se kemi me bërë të pamundurën që këtë kërkesë me realizue për qytetarët e asaj zone.


Kryesuesja – Ju sqaroj se brenda 6 jave, nga dita që vjen peticioni duhet të paraqitet në Kuvend dhe për me u marrë një vendim i prerë duhet prej 3 muajve nga dita e paraqitjes në Kuvend. Ne në Kuvend do ta shqyrtojmë dhe aty do të jenë edhe drejtorët të cilët i marrin rekomandimet që sigurisht se do ti shqyrtojnë edhe më detajisht. Kjo, nuk do të thotë ndoshta, në këtë mbledhje por të vijnë me një sqarim se çka po ndodhë atje, qysh është mundësia dhe të merret një vendim i arsyeshëm në radhë të parë për banorët e atij vendi. Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Peticionit (Ankesa) nr.-II-7457/24 e dt.13.03.2024 nga banorët e fshatit Graboc i Epërm për rrugën e cila lidhë fshatin Graboc me Obiliqin.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Meqë, nuk kemi diskutime për këtë pikë të rendit të ditës, më lejoni të ju uroj agjërim të lehtë të gjithë agjëruesve dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:29'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuese e KPF


Vlora Mjekiqi Kabashi

